




International
Labour
Organization



Si të parandalohen dhe eliminohen
format më të këqija të punës së fëmijëve:

**Çfarë mund të
bëjnë punëdhënësit?**

**Si të parandalohen dhe eliminohen
format më të këqija të punës së fëmijëve:
Çfarë mund të bëjnë punëdhënësit?**

Të drejtat e rezervuara © Organizata Ndërkombëtare e Punës 2010

Botuar për herë të parë 2010

Botimet e Zyrës Ndërkombëtare të Punës i kanë të drejtat e rezervuara sipas Protokollit 2 të Konventës Universale për të Drejtën e Autorit. Megjithatë, fragmente të shkurtra mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të përmendet burimi. Për të drejtat e riprodhimit apo përkthimit, duhet aplikuar pranë sektorit të ZNP-së për botime (të drejtat dhe lejet), Zyra Ndërkombëtare e Punës, CH-1211 Gjenevë 22, Zvicër, ose përmes postës elektronike: pubdroit@ilo.org. Zyra Ndërkombëtare e Punës i mirëpret kërkesat e tilla. Bibliotekat, institucionet dhe përdoruesit tjerë të regjistruar nga organizata me të drejta riprodhimi mund të bëjnë kopje në pajtim me licencat lëshuar atyre për këtë qëllim. Vizito www.ilo.org për informata në lidhje me organizatat për të drejtat e riprodhimit në vendin tuaj.

IPEC

Si të parandalohen dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve: Çfarë mund të bëjnë punëdhënësit/International Labour Office, ILO International Programme on Elimination of the Child Labour (IPEC), Geneva:ILO, 2010-1v.

ISBN 978-92-2-824079-5 (Print), 978-92-2-824080-1 (Web PDF)

International Labour Office; ILO International Programme on the Elimination of Child Labour

child labour / employers role / employers organization / Serbia - 13.01.2

Poashtu në dispozicion: versioni në gjuhën angleze, *How to prevent and eliminate the worst forms of child labour: What can employers do*, ISBN 978-92-2-124079-2 (Print); 978-92-2-124080-8 (Web PDF), Geneva, 2010; versioni në gjuhën serbe, *Kako sprečiti i eliminisati najgore oblike dečijeg rada: Šta poslodavci mogu da učine*, ISBN 978-92-2-824081-8 (Print), 978-92-2-824082-5 (Web PDF), Geneva, 2010.

ILO Cataloguing in Publication Data

Mirënjohjet

Ky publikim është përgatitur prej Zn. Drilona Emrullahu për IPEC-un dhe është koordinuar prej Zn. Lindita Boshtrakaj nga zyra e IPEC-ut në Kosovë.

Financimi për përgatitjen e këtij publikimi të ZNP-së është mundësuar nga Qeveria Italiane.

Financimi për botimin e këtij publikimi të ZNP-së është mundësuar nga Ministria Federale e Gjermanisë për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Projekti RER/09/51/FRG).

Ky publikim nuk e pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Qeverisë Italiane apo të Ministrisë Federale të Gjermanisë për Kooperim Ekonomik dhe Zhvillim, e as nuk përmend ndonjë markë tregtare, produkt komercial apo organizatë që kanë përkrahje nga Qeveria Italiane apo Qeveria Gjermane.

Përkufizimet e përdorura në botimet e ZNP-së, që janë në përputhje me praktikën e Kombeve të Bashkuara, si dhe prezantimi i materialit, nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë mendimi nga ana e Zyrës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, zone apo territori apo të autoriteteve përkatëse të tyre, si dhe përcaktimin e kufijve të tij.

Përgjegjësia për mendimet e shprehura në artikujt, studimet, apo kontributet tjera të nënshkuara qëndron vetëm tek autorët e tyre, ndërsa botimi i tyre nuk nënkupton përkrahje nga ana e Zyrës Ndërkombëtare të Punës, për mendimet e shprehura në to.

Referencat emrave të firmave dhe produkteve e proceseve komerciale nuk nënkuptojnë përkrahjen e tyre nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, ndërsa mospërmendja e ndonjë firme të caktuar, produkti apo procesi komercial nuk është shenjë mosaprovimi.

Botimet e ZNP-së mund të merren përmes librarive të njohura apo në zyrat lokale të ZNP-së në shumë vende të botës, ose drejtpërdrejtë nga sektori i botimeve të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, CH-1211 Gjenevë 22, Zvicër. Katalogët apo listat e publikimeve të reja janë të disponueshme falas në adresën e mësipërme, ose mund të kërkojnë përmes postës elektronike: pubvente@ilo.org.

Vizitoni faqen tonë të internetit: www.ilo.org/ipcc


Shtypur në
Fotokompozuar prej

Kosovë
Rrota

Përmbajtja

Hyrje

- I. Përkufizimi i punës së fëmijëve
 - a. Çfarë është puna e fëmijëve
 - b. Përkufizimi i punës së lehtë
 - c. Përqëndrimi në format më të këqija të punës së fëmijëve
 - d. Çfarë është puna e rrezikshme e fëmijëve
- II. Puna e fëmijëve në Kosovë
 - a. Shkaqet e punës së fëmijëve
 - b. Pasojat e punës së fëmijëve
 - c. Përgjigja ekzistuese ndaj punës së fëmijëve
 - d. Korniza institucionale për parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së
 - e. Çështjet urgjente në parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së
- III. Dialogu social në Kosovë dhe profili i organizatave të punëdhënësve
 - a. Oda Ekonomike e Kosovës
 - b. Aleanca Kosovare e Bizneseve.
- IV. Përse punëdhënësit dhe organizatat e punëdhënësve në Kosovë duhet të përfshihen në parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së
 - a. Pajtueshmëria me ligjin
 - b. Zgjerimi i qasjes së tregut
 - c. Përmirësimi i produktivitetit
 - d. Etika- gjëja e duhur
- V. Si punëdhënësit dhe organizatat e punëdhënësve në Kosovë mund të mbështesin veprimet për parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së
 - a. Si punëdhënësit mund të parandalojnë dhe eliminojnë FKPF në Kosovë
 - i. Informohu me kërkesat ligjore
 - ii. Eliminimo punën e rrezikshme të fëmijëve nga zinxhiri furnizues
 - iii. Mbështet fëmijët dhe familjet e tyre
 - iv. Përdor kodin e mirësjelljes
 - b. Si organizatat e punëdhënësve në Kosovë mund të mbështesin veprimet për parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së
 - i. Ofro informata dhe këshilla
 - ii. Lobo, lehtëso dhe vetëdijëso
 - iii. Realizo programe
- VI. Çfarë më tej?
 - a. Analizo situatën në biznesin tuaj
 - b. Planifiko strategjinë tuaj
- VII. Shembull i një përvoje të mirë



Hyrje

Kosova¹ përshkruhet si shoqëria më e varfër dhe më e re në Ballkan: 45% e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë, ndërsa 16% në varfëri të skajshme², shkalla e papunësisë është mbi 50%, ndërsa 50% e popullsisë është nën moshën 25 vjeçare. Fëmijët dhe familjet me fëmijë nën moshën 14 vjeçare janë ndër grupet më të prekura, pra 25% e tyre janë më të rrezikuar që të jetojnë në varfëri të skajshme³. Varfëria e shtyn një numër të madh të fëmijëve të braktisin shkollimin dhe të fillojnë punën qysh nga moshë 10 vjeçare, në mënyrë që të mbështetin familjet e tyre. Fëmijët e përfshirë në format më të këqija të punës së fëmijëve (FKPF), ose ata që janë nën moshën minimale për t'u pranuar në punë ose për shkak se ata punojnë në punë të rrezikshme, të paligjshme apo kushte degraduese, nuk janë në gjendje që të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë.

Programi ndërkombëtar i ILO-së për eliminimin e punës së fëmijëve (IPEC) është i pranishëm në Kosovë që nga viti 2004. Aktivitetet kryesore të saj janë përqendruar në: përfshirjen e çështjes së punës së fëmijëve në legjislacionin dhe politikat përkatëse, ndërtimin e kapaciteteve të autoriteteve publike, organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve, zhvillimin dhe testimin e Sistemit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve (SMPF), ofrimin e shërbimeve të drejt-përdrejta për fëmijët e përfshirë në FKPF apo që janë në rrezik për t'u përfshirë në FKPF dhe ngritjen e vetëdijes.

Duke u bazuar në përvojën e IPEC-ut, organizatat e punëdhënësve e shohin rolin e tyre lidhur me anëtarët e tyre për të ngritur zërin për çështjet e punëdhënësve dhe ofrimin e shërbimeve të cilat u shtojnë vlerën bizneseve dhe anëtarëve të tyre. Pasi që anëtarësia e tyre është e përbërë nga sektori formal, çështja e formave më të këqija të punës së fëmijëve nuk është në përgjithësi një shqetësim i madh për ta. Përveç kësaj, punëdhënësit individual nuk e shohin rolin e tyre në parandalimin/luftimin e punës së fëmijëve pasi ata thonë se nuk i punësojnë fëmijët që janë nën moshën minimale për punësim.


Duke ditur se partnerët social janë lojtarë të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për eliminimin e punës së fëmijëve, aktivitetet e IPEC-ut në vitin 2009 janë përqendruar në fuqizimin e përfshirjes së tyre në veprime dhe reagime kundër punës së fëmijëve.

Broshura është përgatitur në kuadër të projektit të IPEC-ut "Format më të këqija të punës së fëmijëve në Kosovë", të financuar nga Qeveria Italiane në kuadër të aranzhimeve plotësuese të buxhetit të rregullt. Ajo është përgatitur në bazë të "Udhëzimit për punëdhënësit: Eliminimi i punës së fëmijëve" i hartuar nga zyra e ILO-së për aktivitete me punëdhënësit (ACTEMP) në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Punëdhënësve (IOE) në vitin 2007, në konsultim dhe me angazhimin aktiv të udhëheqësisë së lartë të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe punëdhënësve individual. Ajo ka për qëllim të ndihmojë punëdhënësit dhe shoqatat e tyre të kuptojnë dhe të marrin masa kundër punës së fëmijëve dhe të shërbejë si një udhërrëfyes i veprimeve praktike që punëdhënësit dhe organizatat e punëdhënësve mund të ndërmarrin për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

¹ Në tërë broshurën referencat Kosovës duhet të nënkuptohen brenda kuptimit të Rezolutës së KS të OKB-së 1244 të vitit 1999

² Studim i varfërisë nga Banka Botërore, 2005

³ Studim i varfërisë nga Banka Botërore, 2005



I. Përkufizimi i punës së fëmijëve

a. Çfarë është puna e fëmijëve

Puna e fëmijëve përkufizohet si punë që dëmton mirëqenien e fëmijës dhe pengon edukimin, zhvillimin dhe jetesën e tij/saj në të ardhmen. Puna e fëmijëve është punë, e cila për nga natyra dhe/ose mënyra e zhvillimit të saj dëmton, abuzon dhe shfrytëzon fëmijën dhe i mohon fëmijës të drejtën në arsim.

Pjesa më e madhe e shteteve në botë kanë përcaktuar moshën minimale për punë. Shumë shtete po ashtu edhe kanë përkufizuar punën e rrezikshme në legjislacionin e tyre kombëtar dhe kanë ndaluar këtë formë të punës për fëmijë, përfshirë fëmijët të cilët janë nën moshën minimale për punë dhe nën moshën 18 vjeçare, duke obliguar kështu ndërmarrjet të veprojnë në pajtim me këto dispozita.

Në pajtim me Konventën Nr. 138 të ILO-s për Moshën Minimale të Punësimit (C138), Ligji Themelor i Punës në Kosovë ndalon punën e fëmijëve nën moshën 15 vjeçare, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndjekin arsimin e detyruar. Moshë 18 vjeçare është përcaktuar për futjen në punësim të rrezikshëm. Kjo është fuqizuar edhe më tej përmes Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm të nxjerrë në vitin 2002, i cili garanton të drejtën në arsim fillor për të gjithë fëmijët nën moshën 15 vjeçare.

b. Përkufizimi i punës së lehtë

Në pajtim me Konventën Nr. 138 të ILO-së për Moshën Minimale të Punësimit (C138), puna e lehtë është përcaktuar në **Ligjin Themelor të Punës** (2001-27) si punë që nuk është e dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, dhe që nuk ndikon në vijimin e shkollimit.

c. Përqendrimi në format më të këqija të punës së fëmijëve

Konventa e ILO-së për Format më të këqija të punës së fëmijëve (C182) u miratua unanimisht nga të gjithë delegatët e ILO-së në vitin 1999 dhe mbulon të gjithë fëmijët derisa mbushin moshën 18 vjeçare. Siç sugjeron dhe titulli, kjo Konventë ka të bëjë me llojet e punëve të cilat nuk duhet të kryhen nga fëmijët.

Neni 3 i kësaj Konvente përcakton format më të këqija të punës së fëmijëve, të jenë:

- të gjitha format e skllavërisë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë, siç janë shitja dhe trafikimi i fëmijëve, detyrimi skllavëruar dhe bujkrobëria dhe puna pa dëshirë ose e detyruar, përfshirë rekrutimin pa dëshirë ose të detyruar për përdorim në konflikte të armatosura;
- përdorimi, gjetja ose dhënia e një fëmije për prostitucion, për prodhim pornografie ose për shfaqje pornografike;
- përdorimi, gjetja ose dhënia e një fëmije për veprimtari të paligjshme, në veçanti për prodhimin dhe trafikimin e drogave narkotike, siç janë përkufizuar në traktatet ndërkombëtare;
- puna, e cila për shkak të natyrës apo rrethanave në të cilat zhvillohet, mund të rrezikojë shëndetin, sigurinë dhe moralin e fëmijëve.

Kategoria e katër (d) referohet si Punë e rrezikshme e fëmijëve dhe ka të bëjë me punën që mund të rezultojë me: vdekje, lëndime apo sëmundje të rënda, si pasojë e standardeve të ulëta të vendit të punës, të sigurisë dhe shëndetit, të kushteve dhe marrëdhënies së punës. Në disa raste, puna e rrezikshme mund të shndërrohet në punë jo të rrezikshme duke përmirësuar kushtet e punës dhe duke shtuar masat mbrojtëse.

d. Çfarë është puna e rrezikshme e fëmijëve

Për shkak se ekonomitë, industritë, kushtet dhe proceset e prodhimit ndryshojnë nga vendi në vend, Neni 4 i Konventës së ILO nr. 182 kërkon që çdo vend të përgatis listën e punëve të rrezikshme, në konsultim me organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësit në fjalë.

Udhëzimi Administrativ mbi Parandalimin dhe eliminimin e punës së rrezikshme të fëmijëve që ka hyrë në fuqi më datën 25 shtator 2008 përcakton regjistrin e sektorëve të rrezikshëm dhe aktivitetet e rrezikshme që duhen ndaluar urgjentisht në Kosovë.

Aktivitetet e përgjithshme të ndaluara për fëmijët deri në moshën 18 vjeç përfshijnë:

- 1) Puna e natës, ndërmjet orës 20:00 dhe 06:00
- 2) Ngritja dhe bartja e kohëpaskohshme e peshave të rënda mbi 15 kg (meshkuj) dhe 10 kg (femra)
- 3) Ngritja dhe bartja e vazhdueshme mbi 10 kg (meshkuj) dhe 5 kg (femra)
- 4) Puna që kërkon ekuilibër të veçantë
- 5) Puna në thellësi, nën sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe vende të mbyllura
- 6) Puna në lartësi mbi 2 metra
- 7) Puna që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e tyre, për shkak të ekspozimit ndaj temperaturave ekstreme të larta apo të ulëta, apo ndaj zhurmës dhe dridhjes
- 8) Puna që përfshin ekspozim ndaj substancave biologjike, kimike, fizike, dhe toksike të dhe ekspozim ndaj radioaktivitetit.

Aktivitetet e ndaluara për “fëmijët” në sektorët e mëposhtëm janë:

- 1) Sektori i bujqësisë dhe pylltarisë
 - Operimi me makineri bujqësore
 - Spërkatja me pesticide
 - Puna në korrje-shirje
 - Puna e rëndë fizike në fusha
 - Prerja e drunjve
 - Puna në thertore (therja, bartja dhe shitja e kafshëve).
- 2) Puna në rrugë
 - Ndalohen të gjitha punët në rrugë për fëmijët nën moshën 15 vjeçare
 - Ndalohet puna në rrugë e fëmijës prej moshës 15 deri 18 vjeçare, si:
 - Ngarkimi i mallrave
 - Pastrimi i parafangove të automjeteve
 - Bartja e mallrave me karrocë
 - Kërkimi i lëmoshës
- 3) Mbledhja e mbeturinave për riciklim
 - Puna e fëmijëve në hulumtimin, grumbullimin dhe bartjen e materialeve të hedhura
- 4) Puna në eksploatimin e pasurive natyrore
 - Puna e fëmijëve në eksploatimin e pasurive natyrore.

II. Puna e fëmijëve në Kosovë

a. Shkaqet e punës së fëmijëve

Ka shumë arsye që i nxisin fëmijët drejt punës, sidoqoftë faktori më i rëndësishëm mbetet varfëria. Familjet e varfra i shtojnë fëmijët të punojnë në mënyrë që të shtojnë të ardhurat e tyre të pamjaftueshme. Varfëria është njëkohësisht edhe shkak e edhe pasojë e punës së fëmijëve. Varfëria dhe puna e fëmijëve janë komponentet kryesore të "ekuilibrit të ulët ekonomik" në nivel të familjes, komunitetit dhe vendit. Për këtë arsye, puna e fëmijëve është një pikë themelore për ndërhyrje në masat që merren për zbutjen e varfërisë dhe mbrojtjen sociale, edhe në mes të familjeve shumë të varfra, për të cilat është vështirë të gjenden zgjidhje të qëndrueshme (përveç asistencës direkte sociale).

Përveç varfërisë, ka shumë faktorë të tjerë që kontribuojnë në punën e fëmijëve:

Qëndrimi përkrahës ndaj punës së fëmijëve – Prindërit (mësuesit dhe shoqëria në përgjithësi) mund ta shohin punën e fëmijëve si pjesë e edukimit të tyre, veçanërisht kur arsimimi ekzistues nuk ofron përfitime ekonomike për të rinjtë. Prindërit mund ta mbështesin punën e fëmijëve si një mënyrë për t'i mbajtur fëmijët të sigurt, në disa zona ku fëmijët mund të diskriminohen apo të jenë subjekt i dhunës në shkollë.

Mjedis jo i favorshëm familjar – familjet me një prind, me kryefamiljar të sëmurë apo të paaftë fizikisht, varësia nga alkooli apo droga e prindërve, paaftësia prindërore, abuzimi e vendosin fëmijën në rrezik të madh për t'u përfshirë në punën e fëmijëve.

Mungesa e qasjes në arsim – kostot e drejtpërdrejta dhe indirekte të edukimit (përfshirë këtu uniformat shkollore, librat dhe pajisjet shkollore, si dhe udhëtimin për në shkollë) janë shumë të larta për prindërit që të mundësojnë ndjekjen e shkollës nga fëmijët dhe/ose shkollat janë në një distancë shumë të madhe.

Diskriminimi – minoritete apo komunitete të caktuara kanë më pak qasje në arsim apo në tregun e punës, prandaj edhe kjo shton mundësinë që këta fëmijë të kryen detyra të caktuara që në moshë të re. Për më tepër, ndarja e punës në bazë gjinore mund t'i detyrojë meshkujt dhe femrat që të kufizojnë perspektivat e tyre të punës deri në një shkallë të caktuar që nuk kërkon arsimim, por "praktikë pune" që nga moshat e reja, përfshirë dhe punën në shtëpi.

Përhapja e sektorit joformal dhe mungesa e zbatimit të ligjit – Mungesa e kontratave të punës dhe e së drejtës së krijimit të asociacioneve/negociatave kolektive në sektorin joformal e bën më të vështirë mbrojtjen e fëmijëve nga kushtet abuzive të punës, si dhe vetë identifikimin e fëmijëve që punojnë.

Shkalla e lartë e migrimit – ka kontribuar shumë në rritjen e të ardhurave në shkallë vendi. Por gjithashtu migrimi ka luajtur një rol në dobësimin e mbështetjes sociale për fëmijë, sepse shërbimet shtetërore në zonat periferike nuk kanë qenë në gjendje të përballojnë fluksin e emigrantëve nga zonat rurale.

Moszbatimi i parimit të sundimit të ligjit – ka lejuar ekonominë në hije të lulëzojë dhe korrupsionin që të pushtojë shumë aspekte të jetës së njerëzve. Kjo gjë ka ndikim të drejtpërdrejtë në a) rastet e formave të këqija të punës së fëmijëve që kanë lidhje me aktivitetet kriminale (aktivitete të jashtëligjshme, trafikim dhe prostitucion – kur një gjë e tillë është kriminalizuar), dhe b) në zbatimin e ligjeve dhe politikave të ndërlidhura me punën e fëmijëve.

Mjedisi pas konfliktit dhe ai transitor – krijon një treg për mallra, armë dhe qenie njerëzore, që monopolizohet nga grupe të organizuara kriminale. Po ashtu, ky mjedis rrit dhe tolerancën e publikut ndaj aktiviteteve të paligjshme.

Ekzistenca e përkohshme e një “vakuumi vlerash” – në të cilin presioni i konsumimit përëndimor në konkurrencë me vlerat tradicionale, si dhe tërheqja personale në masë ekstreme, sjellin në: a) prishjen e bazës së vlerave të familjes dhe komunitetit; dhe b) rritjen e rrezikshmërisë së fëmijëve. Për shkak të mungesës së një mbikëqyrjeje dhe kujdesi të duhur, rruga është bërë vendi kryesor për shoqërizimin e fëmijëve.

b. Pasojat e punës së fëmijëve

Fëmijët që përdoren për punë apo shfrytëzohen seksualisht lëndohen në aspektin psikologjik, moral dhe fizik. Më poshtë janë përmasat se deri në ç’skallë preken fëmijët nga forma të ndryshme të punës, nga pikëpamja e shëndetit dhe e sigurisë:⁴

- plagosjet apo gjymtimet fizike që shkaktohen nga makineritë që nuk janë mirëmbajtur mirë apo aksidentet me thika (machete) në plantacione
- helmimi nga pesticidet
- mungesa e rritjes është e dukshme tek fëmijët që punojnë, të cilët janë më të shkurtër dhe më të dobët sesa fëmijët tjerë; këto mangësi ndikojnë edhe në jetën e tyre më vonë kur këta të jenë në moshë të rritur.
- problemet afatgjata shëndetësore, si sëmundjet respiratore, apo lloje të ndryshme të kancerit janë të zakonshme në vendet ku fëmijët detyrohen të punojnë me kimikate të rrezikshme.
- HIV/AIDS-i apo sëmundjet tjera ngjitëse seksuale janë të përhapura në mes të fëmijëve që detyrohen të trafikohen çdo vit. Shtatzënitë e padëshirueshme, varësia nga droga apo sëmundjet mendore janë po ashtu të zakonshme në mes të fëmijëve që përdoren për shfrytëzim seksual.
- stërlodhja dhe mungesa e ushqimit të duhur shfaqen si rezultat i angazhimit të fëmijëve në punë të rënda fizike, në punë me orë të gjata në kushte të papërbalueshme, pa arritur të fitojnë në sasinë e duhur që të ushqejnë veten e tyre.

Puna mund të ketë dhe ndikim negativ në zhvillimin mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të fëmijës për shkak të:

- pamundësisë për të ndjekur shkollën normalisht. Për shkak se nuk i ndjekin mësimet apo për shkak se janë tepër të lodhur për t’u përqendruar tek lëndët mësimore, fëmijët që punojnë nuk ndjekin një arsimim normal.
- prishjes së rrjeteve sociale (fëmijët që punojnë nuk kanë kohë të takohen me shokët e tyre) për sa kohë që mungesa në shkollë i pengon fëmijët që punojnë të shoqërohen me bashkëmoshatarët e tyre dhe të luajnë me ta.
- aktiviteteve jo-stimuluese dhe monotone që kanë një ndikim negativ në kreativitetin/fleksibilitetin e ardhshëm të fëmijëve. Tregtia/shitja apo aktivitetet e tjera që mësojnë të bëjnë fëmijët që punojnë janë specifike dhe kërkojnë aftësi të ulëta. Kjo gjë i pengon fëmijët që të fitojnë fleksibilitetin e duhur dhe aftësitë e nevojshme për të përfituar nga mundësitë në moshën e rritur.
- të gjitha format e keqtrajtimeve, përfshirë neglizhencën, trajtimin jo të duhur dhe të rëndë, dhunën emocionale dhe shtrëngimin.

⁴ Fondacioni ECLT, 2005, <http://www.eclt.org/about/overview.html>.

c. Përgjigja ekzistuese ndaj punës së fëmijëve

Që nga viti 2004, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka dëshmuar zotimin e saj për adresimin e çështjes së punës së fëmijëve përmes veprimeve të mëposhtme:

- 1) Nënshkrimi të memorandumit të mirëkuptimit për zbatimin e programit ndërkombëtar të ILO-së për eliminimin e punës së fëmijëve (IPEC) nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, në vitin 2005;
- 2) Krijimi i Njesisë për Punën e Fëmijëve në MPMS në mars të vitit 2005;
- 3) Krijimi i Komitetit të Kosovës mbi Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve (KKPEPF) me Vendimin e Kryeministrit të Kosovës Nr. 5 / 166, të datës 13 dhjetor 2005;
- 4) Krijimi i Grupit Teknik për Monitorimin e Punës së Fëmijëve (GTP MPF) me Vendimin e KKPEPF-së Nr. 01/02, të datës 12 qershor 2006;
- 5) Përgatitja e Profilit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Kosovë, miratuar nga KKPEPF-ja më datën 5 mars 2007;
- 6) Nxjerra e Udhëzimit Administrativ mbi Parandalimin dhe eliminimin e punës së rrezikshme të fëmijëve, përfshirë edhe sektorët e rrezikshëm dhe aktivitetet e rrezikshme që duhen ndaluar urgjentisht në Kosovë, më datën 25 shtator 2008;
- 7) Ofrimi i mbështetjes institucionale dhe sigurimi i pjesëmarrjes aktive të institucioneve publike në nivelin qendror dhe lokal në testimin e intervenimeve të ndryshme për adresimin e çështjes së punës së fëmijëve, mbështetur nga IPEC, gjatë periudhës 2004-2009;
- 8) Nisja e procesit për krijimin e Sistemit për monitorimin e punës së fëmijëve, në pajtim me nenin 5 të Konventës së ILO-së nr. 182, për të shërbyer si bazë për formalizimin e procedurave standarde të veprimit për:
 - identifikimin, tërheqjen, mbështetjen dhe mbrojtjen e fëmijëve nga KKPF,
 - dokumentimin e trendëve të punës së fëmijëve në sektorë specifikë
 - vlerësimin e efikasitetit të ndërhyrjeve ekzistuese në nivel lokal, duke përfshirë rekomandimet dhe udhëzimet për veprime konkrete dhe hartimin e politikave.

Deri më tani, strukturat e sistemit të monitorimit të punës së fëmijëve në nivelin qendror janë krijuar dhe trajnuar, janë zhvilluar mjetet dhe është bërë testimi i sistemit në gashtë lokacione (Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Obiliq, Gjilan dhe Drenas). Sfidat e hasura gjatë fazës së testimit janë dokumentuar dhe përdorë si mësim të mësuara për planifikimin e përsëritjes së sistemit të monitorimit të punës së fëmijëve në tërë Kosovën. Plani i punës për përsëritjen e sistemit të monitorimit të punës së fëmijëve është miratuar nga KKPEPF-ja në takimin e datës 9 shkurt 2010 dhe zbatimi është në proces e sipër.

- 9) Hartimi i Planit të Veprimit për parandalimin dhe eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve (2010-2012), për të përcaktuar synime për t'u arritur brenda një afati kohor dhe për të dhënë dëshmi të qartë për zotimet e autoriteteve publike sa i përket përgjegjësi dhe ndarjes së buxhetit për realizimin e planit.

d. Korniza institucionale për parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së

Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve (KNDF) është themeluar në vitin 2006 dhe kryesohet nga Kryeministri. Me këtë mekanizëm, Qeveria e Republikës së Kosovës synon të arrijë standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si dhe të ndihmojë në përmirësimin e

efektshmërisë së mekanizmave ekzistues dhe të garantojë se normat e pranuar mbi të drejtat e fëmijës zbatohen dhe respektohen.

Komiteti i Kosovës mbi Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve (KKPEPF) është themeluar nga viti 2005 (Vendimi nr. 5/166 nga 13 Shtator 2005 i Kryeministrit të Kosovës) për të mbikëqyrur aktivitetet për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve si dhe për të udhëzuar për intervenimet e nevojshme politike dhe programe për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve. KKPEPF përbëhet nga përfaqësues të Zyrës për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe një përfaqësues nga OJQ aktive në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Grupi Teknik për Monitorimin e Punës së Fëmijëve (GTP MPF), është grup i themeluar nga KKPEPF-ja në qershor 2006 për të përgatitur Profillin e Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Kosovë duke përshkruar procedurat standarde të veprimit në nivel lokal dhe qendror a) për mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve që janë përfshirë në punë të rrezikshme të fëmijëve (PRRF) dhe b) për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave në lidhje me PRRF. Profili i MPF u miratua nga KKPEPF në mars 2007. GTP MPF është mandatuar gjithashtu për të mbështetur, koordinuar dhe monitoruar procesin e përsëritjes së sistemit të MPF në Kosovë.

Komitetet Lokale të Veprimit (KLV) për monitorimin e punës së fëmijëve (MPF) janë themeluar në gjashtë komuna (nga qershori 2007 në Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë, ndërsa që nga tetori 2008 në Gjilan, Obiliq dhe Gllogoc) në bazë të marrëveshjeve në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Kryetarëve të Komunave, për të koordinuar aktivitetet e MPF në nivel lokal, duke përfshirë a) monitorimin e shkollave/vendeve të punës/familjeve në mënyrë që të identifikohen fëmijët që punojnë, të vlerësohet situata dhe të referohen në shërbime adekuate, siç janë shkollimi dhe zhvillimi i shkathtësive, përcjellja e tyre që të sigurohen se nuk kthehen përsëri në punë dhe verifikimi se fëmijët në rrezik përfitojnë nga alternativa të kënaqshme; b) dokumentimin e mungesës së shërbimeve dhe barrierave për t'u qasur në shërbime për fëmijët që janë në rrezik/ të përfshirë në punë të fëmijëve dhe për familjet e tyre; c) rishikimi i të dhënave mbi punën e fëmijëve nga Qendrat për Punë Sociale; d) përgatitja e planeve vjetore të veprimit për adresimin e punës së fëmijëve në nivel lokal, e) rekomandimet e mëtutjeshme për fuqizimin e reagimeve lokale për punën e fëmijëve dhe për përmirësimin e politikave dhe programeve sociale. KLV-të janë të përbërë nga përfaqësues të autoriteteve komunale, degëve lokale të sindikatave dhe të degëve lokale të organizatave të punëdhënësve, shoqatave prindër-arsimtar, qendra rinore dhe OJQ aktive në mbrojtjen e fëmijëve.

Grupi teknik për Hartimin e Listës së PRRF në Kosovë, i krijuar nga KKPEPF në 14 dhjetor 2005 me mandatin të përgatisë draftin e listës së punëve të rrezikshme për fëmijët bazuar në konsultime me partnerë social dhe shoqërinë civile. Lista u miratua nga KKPEPF në qershor 2007 dhe shërbeu si bazë për hartimin e Udhëzimit Administrativ për Parandalimin dhe Eliminimin e PRRF.

Grupi Teknik Punues për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve, i krijuar nga KKPEPF në takimin e tij me 22 maj 2009 me mandatin që të përgatisë një Strategjinë dhe planin e veprimit, t'ia paraqesë KKPEPF për miratim dhe të përkrah dhe monitoroj zbatimin e tij.

Grupi Ndërmator për Kundër-trafikim është grup i përbërë nga përfaqësues të institucioneve qendrore dhe i kryesuar nga Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, i cili ka për mandat të koordinojë zbatimin e politikave, të monitorojë dhe raportojë arritjet në zbatimin e Planit të Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore. Koordinimi i aktiviteteve në nivel operacional realizohet përmes katër nëngrupeve punuese: a) parandalimi i trafikimit, b) mbrojtja e viktimave të trafikimit, c) ndjekja ligjore e krimit të trafikimit dhe d) mbrojtja e fëmijëve.

e. Çështjet urgjente në parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së

Ndër problemet emergjente të identifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komiteti Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve dhe Qendrat për Punë Sociale që kanë nevojë për trajtim të menjëhershëm janë:

Në nivelin qendror

- Institucionet publike janë ende në konsolidim e sipër dhe të dobëta për adresimin e çështjeve sociale. Po ashtu ka një mungesë të vendosmërisë për të eliminuar format e këqija të punës së fëmijëve përmes zotimeve të fondeve të konsiderueshme publike për këtë qëllim.
- Mungon një bazë elektronike e të dhënave e cila do të mbledhte dhe procedonte të dhënat e procesit të MPF (informacion i detajuar mbi fëmijët e përfshirë në FKPF).
- Planprogrami arsimor është i papërshtatshëm për të përgatitur fëmijët më të rritur për punë në të ardhmen dhe nuk i adreson nevojat, vlerat dhe aspiratat e fëmijëve që janë në rrezik për të braktisur shkollën.
- Mungesa e një përpjekjeje të harmonizuar të partnerëve në fushën sociale për të luftuar FKPF. Eksperienca e sindikatave në luftimin e formave të këqija të punës së fëmijëve është akoma e kufizuar dhe në baza ad hoc. Organizatat e punëdhënësve do të mund të bënin më shumë, për sa i përket: a) përfshirjes së punës së fëmijëve në kodet e tyre të mirësjelljes, si për aktivitetet e tyre ashtu edhe për qasjen ndaj zinxhirit furnizues (veçanërisht kur në sektorët e tyre ka nënkontraktime me ndërmarrës në ekonominë joformale); b) pjesëmarrjes financiare në aktivitetet përgjegjëse sociale të cilat janë të drejtuara kah eliminimi i punës së fëmijëve; c) ofrimin e mundësive për punësim për familjet e rrezikuara. Partnerët socialë kanë nevojë për mbështetje më të madhe, për të fuqizuar angazhimin e tyre në adresimin e punës së fëmijëve përmes diversifikimit të shërbimeve dhe ofrimin e tyre.
- Mungesa e shkathtësive dhe përvojës që do të mund të ndihmonte për të: a) vlerësuar ndikimin dhe efektivitetin financiar të një ndërhyrjeje të caktuar; b) identifikuar, vlerësuar dhe shkëmbyer shembuj të praktikave të mira; dhe d) për të përsëritur praktikën e mira në projekte të tjera, më të mëdha dhe për të shfrytëzuar mësimet e nxjerra në reformimin e politikave. Një sistem operativ i menaxhimit të njohurive është i nevojshëm për të siguruar grumbullimin, vlerësimin dhe përsëritjen e praktikave të mira, mjeteve dhe modeleve të ndërhyrjes.

Në nivelin lokal:

- Institucionet për mbrojtjen e fëmijëve, të përfshira në procesin e monitorimit të punës së fëmijëve zakonisht kanë një mungesë të shtrirjes në komunitet, si e kërkon pesha e këtij problemi. Kjo mungesë e shtrirjes fizike vjen për shkak të mandateve të kufizuara të disa institucioneve, mungesës së një veprimit të koordinuar, numrit të vogël të stafit dhe sidomos të atij të kualifikuar, si dhe për shkak të alokimeve të kufizuara për shpenzime administrative dhe logjistike, që pamundësojnë zbatimin efektiv të funksioneve të tyre (përfshirë telefonat, karburantin për makinat dhe gjeneratorët, mirëmbajtjen e

Si të parandalohen dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve Çfarë mund të bëjnë punëdhënësit?

makina etj.). Për më tepër, shërbimet e kufizuara që janë në dispozicion në nivelin lokal për të mbështetur parandalimin e fëmijëve në rrezik për t'u përfshirë në FKPF dhe për të tërhequr e reintegruar fëmijët e përfshirë në FKPF përbëjnë një faktor tjetër që rrezikon përfshirjen aktive të QPS-ve dhe partnerëve të tjerë në nivelin lokal në identifikimin e fëmijëve punëtorë (për shkak se për shumë familje të fëmijëve punëtorë, të ardhurat e vetme vijnë nga puna e fëmijëve dhe/ose ndihma sociale).

- Sistemi i arsimit nuk kontribuon në mënyrë efektive për përfshirjen sociale të fëmijëve të rrezikuar. Mësuesit shpesh kanë mungesë kapacitetesh për të dhënë një mbështetje shumëdimensionale për fëmijët në rrezik apo fëmijët viktimë të FKPF. Mësimi në ndërrime, numri relativisht i madh i nxënësve në një klasë dhe mungesa e shërbimeve profesionale në shkollë kufizon përfshirjen e shkollës për realizimin e rolit të saj në identifikimin dhe mbështetjen e tërheqjes, reintegrimit dhe procesit të monitorimit të fëmijëve të tërhequr nga puna.
- Mungesa e një granti emergjence për divizionin e shërbimeve sociale për të mbuluar nevojat e menjëhershme të përfituesve derisa të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme (shërbime të kujdesit shëndetësor, përfshirë dhe ilaçet, transportin, ushqimin, etj.);
- Mungesa e fondeve për Qendrat për Punë Sociale, për t'u mundësuar atyre të ofrojnë: a) "kuponë ushqimi" për familjet e fëmijëve në nevojë, b) mjete shkollore dhe ushqim për fëmijët që janë regjistruar në shkollë, c) mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijët që duhet të udhëtojnë drejt shkollës dhe anasjelltas apo bursa për fëmijët që kanë punuar dhe janë kthyer në shkollë me qëllim që të parandalohet largimi nga shkolla (për familjet që nuk kanë plotësuar kriteret e skemës së asistencës sociale ose për familjet për të cilat kjo skemë është e pamjaftueshme);
- Disa shërbime të kufizuara mund të mbështesnin parandalimin e rrezikut tek fëmijët dhe nxjerrjen e atyre të përfshirë në FKPF, si për shembull: a) qendra të kujdesit ditor që do të mund të ofronin programe të mbështetjes emocionale, rehabilitimit social, programe mbështetëse arsimore për të mbërritur në nivelin e kërkuar shkollore, b) programe edukimi në mesin e bashkëmoshatarëve nëpër shkolla për të parandaluar braktisjen e shkollës dhe për të përmirësuar frekuentimin dhe notat e fëmijëve që mësojnë, c) aktivitete joformale arsimore; dhe d) programe shtesë për ofrimin e ndihmës për mësim plotësues.
- Mungesa e koordinimit dhe e rrjeteve në mes të partnerëve kyç në nivelin lokal, në veçanti në mes të Qendrave për Punë Sociale dhe inspektorëve të punës, instituteve të tregut të punës, shkollave dhe autoriteteve shëndetësore.
- Përfshirja e kufizuar e komunitetit të biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile për të adresuar punën e fëmijëve.

Për më tepër, Njësia për Punën e Fëmijëve dhe strukturat tjera institucionale duhet të fuqizohen akoma më shumë për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre për eliminimin e FKPF-së.

III. Dialogu social në Kosovë dhe profili i organizatave të punëdhënësve

Autoritetet publike janë përgjegjëse për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e ekonomisë, paqes sociale, si dhe krijimin e një bazë juridike për dialog social.

Një Këshill trepalësh është themeluar në vitin 2001 në bazë të Udhëzimit Administrativ 17/2001 në mënyrë që të fillojë procesin e konsultimeve trepalëshe ndërmjet organizatave të punëdhënësve, organizatat e punonjësve dhe qeverisë. Kompetencat e saj përfshijnë: a) të këshillojë qeverinë në lidhje me mirëqenien sociale dhe politikat ekonomike, b) të nxitë nënshkrimin e kontratave dhe marrëveshjeve kolektive në nivel kombëtar dhe lokal, c) të marrë iniciativë për realizimin e aktiviteteve të tjera për punën dhe çështje të mirëqenies sociale me marrëveshjen e pjesëmarrësve të tjerë.

Në 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale themeloi Këshillin Ekonomik dhe Social në bazë të Vendimit nr. 09/57 të Qeverisë, duke zëvendësuar Këshillin trepalësh.

Këshilli Ekonomik dhe Social është institucioni më i lartë jopolitik trepalësh në Kosovë i mandatuar të udhëheqë aktivitetet e përbashkëta të partnerëve socialë në fushën e politikave sociale, ekonomisë, mbrojtjes së të drejtave sociale, zhvillimin e negociatave kolektive dhe përfundimin dhe zbatimin e marrëveshjeve kolektive.

a.Oda Ekonomike e Kosovës është asociacioni më i fuqishëm i biznesit në Kosovë. E themeluar në vitin 1962 nga Kuvendi i Kosovës, OEK-ja është përfaqësuesi i vetëm ligjor i interesave të komunitetit të biznesit. Oda Ekonomike e Kosovës është një organizatë joprofitabile, e pavarur dhe profesionale. Qëllimi kryesor i OEK-së është të zhvillojë ekonominë e tregut, ndërmarrësinë dhe rritjen e aftësive konkurruese të anëtarëve të saj. OEK-ja është e angazhuar të mbrojë dhe përfaqësojë në mënyrën më të mirë të mundshme interesat e anëtarëve të saj, të këshillojë bizneset fillestare, t'u jap ndihmë profesionale anëtarëve të saj dhe në veçanti të promovojë investimet dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Sipas ligjit mbi themelimin e OEK-së, anëtarësimi është në baza vullnetare. OEK-ja përbëhet nga katër departamente kryesore, tridhjetë shoqata sektoriale dhe mbi 15,000 anëtarë të regjistruar.

Anëtarët e Odës operojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë duke përfshirë sektorin e teknologjisë, telekomunikacionit, ndërtimtarisë, bankave dhe kompanive të sigurimit, përpunimit të metaleve, përpunimit të drurit, prodhimit dhe përpunimit të ushqimit dhe pijeve etj.

Oda Ekonomike e Kosovës është anëtar i Këshillit Ekonomik dhe Social me tri ulëse.

Për më tepër informata ju lutem referohuni në faqen e internetit të OEK-së:
www.oek-kcc.org.

b.Aleanca Kosovare e Bizneseve është themeluar në vitin 2002 si një organizatë joqeveritare në bazë të Ligjit nr. 03/L-134 për regjistrimin e OJQ-ve. Ajo përfaqëson 23 shoqata dhe rreth 150 biznese individuale. Veprimtaria e Aleancës Kosovare të Bizneseve drejtohet nga Bordi i Drejtorëve dhe menaxhohet nga ekipi profesional. Shërbimet e saj kryesore janë: a) dhënia e informatave periodike për industrinë e ndryshme sektoriale të pranishme në Kosovë; b) organizimi i misionëve tregtare jashtë Kosovës me qëllim për të nxitur partneritetet ndërkombëtare të biznesit për anëtarët e vet; c) sigurimin e mbështetjes teknike për zhvil-

limin e industrive sektoriale të pranishëm në Kosovë, duke përfshirë zhvillimin e planeve të biznesit, lehtësimi i takimeve të biznesit, publikimin e broshurave për bizneset.

Misioni i AKB-së është që të bashkojë shoqatat afariste dhe bizneset që të ndikojnë në politikat ekonomike dhe zhvillimin e sektorit privat, të ndërtojë partneritet të qëndrueshëm në mes të sektorit privat dhe publik me qëllim të rritjes së punësimit dhe plotësimin e kërkesave të konsumatorëve. AKB-ja ofron trajnime në zhvillimin e biznesit dhe të integritetit të integritetit të ekonomisë kosovare në tregun ndërkombëtar. Aleanca Kosovare e Biznesit i ka dy ulëse në Këshillin Ekonomik dhe Social, si një organizatë joqeveritare e regjistruar.

Për më tepër informata ju lutem referohuni në faqen e internetit të AKB-së: www.akb-ks.org.

IV. Përse punëdhënësit dhe organizatat e punëdhënësve në Kosovë duhet të përfshihen në parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së

Ekzistojnë katër arsye kryesore pse punëdhënësit dhe organizatat e punëdhënësve në Kosovë duhet të kontribuojnë në parandalimin dhe eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve

a. Pajtueshmëria me ligjin

Çdo ndërmarrje duhet të vetëdijesohet se përgjegjësia e tyre morale dhe ligjore i obligon të kontribuojnë në procesin e ndalimit të punës së fëmijëve në bazë të ligjeve ashtu si duhet të pajtohen edhe me kërkesat tjera ligjore. Dështimi në respektimin e ligjit sjell dënime dhe sanksione tjera shtetërore. Organizatat e punëdhënësve mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këshillimin dhe inkurajimin e komunitetit të biznesit për të vepruar në kuadër të ligjit.

b. Zgjerimi i qasjes së tregut


Blerësit ndërkombëtar dhe markat e njohura dëshirojnë të përmbushin standardet e pranuar ndërkombëtare të punës dhe gjithashtu t'i shmangen publicitetit të keq dhe bojkotimeve të mundshme nga konsumatorët. Prandaj ndërmarrjet që dëshirojnë të ruajnë ose zgjerojnë numrin e blerësve duhet të sigurohen se puna e fëmijëve nuk përdoret. Sektorët e industrisë mund të ndërtojnë një reputacion të mirë nga mospranimi i fëmijëve në punë dhe ky reputacion bëhet i njohur tek blerësit të cilët do të kenë një interes më të madh për të bërë porosi. Një organizatë e punëdhënësve që promovon eliminimin e punës së fëmijëve asiston anëtarët e saj në qasje të tregjeve të huaja.

c. Përmirësimi i produktivitetit

Ndërmarrjet shpeshherë punësojnë fëmijë sepse mendojnë se kjo përmirëson përfitimin e tyre. Sidoqoftë kjo është zakonisht me perspektivë afatshkurtër. Fëmijët kanë nivel të shkurtër të vëmendjes, vlerësim më të paktë në lidhje me kontrollin e cilësisë dhe më pak kapacitetet për të përdorur makinerinë. Ata nuk janë fizikisht aq të fortë sa të rriturit. Tutje, ata më lehtë mund të lëndohen nga pajisjet e rënda ose detyrat e vështira që në anën tjetër rrisin koston e ndërlidhur me rekrutimin dhe trajnimin e punëtorëve të rinj. Puna e fëmijëve pengon suksesin afatgjatë të ndërmarrjes sepse ndalon zhvillimin e fuqisë punëtore të trajnuar dhe produktive të punëtorëve të rritur. Një organizatë e punëdhënësve mund të inkurajojë eliminimin e punës së fëmijëve për të përmirësuar performancën e anëtarëve të saj.

d. Etika – gjëja e duhur

Pronari i ndërmarrjes gjithashtu mund të reflektojë mbi ndikimin e biznesit të tij/saj në shoqëri, në kuptim ekonomik dhe në kuptim social ose etik. Pronari kontribuon në ekonomi duke punësuar veten, duke krijuar prodhime dhe duke punësuar të tjerët. Pronari gjithashtu mund të kontribuojë në shoqëri duke vendosur për punësime që njëkohësisht u mundësojnë fëmijëve të vijnë shkollimin. Në anën tjetër, këta fëmijë do të mësojnë më shumë në të ardhmen, ata do të jenë pjesë e fuqisë punëtore më të shkolluar dhe do t'i kontribuojnë ekonomisë më produktive. Një organizatë e punëdhënësve mund të kontribuojë për shoqërinë duke inkurajuar marrjen e vendimeve të tilla që u lejojnë fëmijëve arsimimin.



V. Si punëdhënësit dhe organizatat e punëdhënësve në Kosovë mund të mbështesin veprimet për parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së

a. Si punëdhënësit mund të parandalojnë dhe eliminojnë FKPF në Kosovë

I. Informohu me kërkesat ligjore

Mosha minimale për punë: 15 vjeç (Ligji themelor i punës 2001/27)

Maksimumi i orëve të punës në javë për fëmijët prej 15-18 vjeç: 40 orë (Ligji themelor i punës 2001/27)

Mosha minimale për pune të rrezikshme: 18 vjeç (Ligji themelor i punës 2001/27)

Puna e lehtë: e përkufizuar sipas Ligjit themelor të punës 2001/27

Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve:

Duke u bazuar në Konventën 182 të ILO-së, aktet kriminale ndaj fëmijëve përfshijnë:

- 1) Prostitucionin
- 2) Abuzimin e fëmijëve në pornografi
- 3) Rekrutimin ose regjistrimin e personave të moshës prej pesëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeçare në konflikt të armatosur
- 4) Vendosjen e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe e punës së detyruar
- 5) Trafikimi me njerëz
- 6) Fshehjen e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit me njerëz (Pikat 1 deri 6 të përkufizuara sipas Ligjit penal për të mitur, nr. 8/2004)
- 7) Prodhim dhe përpunim i paautorizuar i drogave narkotike dhe substancave të tjera duke shfrytëzuar një fëmijë ose duke dëmtuar ata (definuar sipas Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, nr. 03/L-002).
- 8) Punët e rrezikshme (të përkufizuara sipas Udhëzimit administrativ nr. 17/2008 për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rrezikshme të Fëmijëve)

II. Elimino punën e rrezikshme të fëmijëve nga zinxhiri furnizues

Përmirëso kushtet e sigurisë në punë dhe shëndetin

Ndërmarrjet mund të sigurojnë një mjedis me rrezik më të ulët, duke krijuar një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm dhe duke mundësuar që fëmijët të punojnë në të njëjtën hapësirë të punës dhe në detyrat e njëjta, por në një mjedis të parrezikshëm në mënyrë që të mos dëmtojnë shëndetin e tij. Me qëllim të ofrimit të një vendi pune të sigurt dhe të shëndetshëm, punëdhënësit mund të konsultohen me personelin mjekësor apo shëndetësor dhe ekspertët e sigurisë.

Largo adoleshentët nga punët e rrezikshme

Një metodë tjetër për eliminimin e punëve të rrezikshme të fëmijëve është që atyre t'u caktohen detyra të ndryshme dhe/ose mjedis i ndryshëm në mënyrë që të krijojnë një punë më të përshtatshme për zhvillimin e tyre.

Për një implementim të suksesshëm të këtij veprimi, menaxherët e lartë duhet të monitorojnë vazhdimisht në mënyrë që të mund të parandalojnë fëmijët të përfshihen në aktivitete apo situata me rrezik të lartë. Për shembull, nëse pronari ose menaxheri do t'i njoftonte dhe të jepte udhëzime punëtorëve të tyre për këtë çështje, atëherë fëmijët mund të largoheshin

nga punët me rrezikshmëri të lartë. Megjithatë, punëtorët mund të jenë nën presion për të aritur normat e caktuara të produktivitetit dhe mund të tentojnë t'i punësojnë fëmijët në këto kushte. Ashtu që menaxhmenti duhet të sigurojë se njëra prej veprimeve të menjëhershme është monitorimi dhe verifikimi kohë pas kohe.

Njofto furnizuesit për kërkesat e biznesit tuaj

Është në interesin e ndërmarrjes për të kontribuar në parandalimin e punës të rrezikshme në zinxhirin e furnizimit. Blerësit ndërkombëtar po bëhen gjithnjë e më të rreptë dhe dëshirojnë që të blejnë produkte vetëm nga kompanitë që respektojnë standardet e caktuara. Prandaj, kompanitë mund të sigurojnë se në zinxhirin e furnizimit të tyre nuk shfrytëzohet fuqia punëtore e fëmijëve, duke informuar furnizuesit e tyre se puna e fëmijëve nuk do të tolerohet dhe duke u shpjeguar për:

- moshën minimale të punësimit dhe përkufizimin e punës së rrezikshme
- standardet tuaja si blerës, nëse janë më të larta sesa standardet ligjore shtetërore
- marrëveshjen për periudhës transitorë, planin dhe hapat të cilët duhet të ndërmerren nga furnizuesi për të larguar punën e fëmijëve
- procedurat e monitorimit, dhe
- pasojat e mos respektimit të marrëveshjes.

Shkruaj kushtet në kontratë

Për të siguruar që furnizuesit i respektojnë kërkesat tuaja, kushtet e punësimit të fëmijëve mund të shkruhen në kontratë. Kontratat me furnizuesit mund të përcaktojnë moshën minimale të punësimit, detyrat e rrezikshme që nuk mund të kryhen nga personat nën moshën 18 vjeçare dhe kushtet tjera të punësimit. Pasojat e shkeljes së kushteve, përfshirë ndërprerjen e mundshme të kontratës, mund të deklarohen qartë për t'iu shmangur konfuzionit. Përderisa disa blerës do të ndërprejnë kontratat me furnizuesit e tyre menjëherë në rast se këta gjenden duke shkelë kushtet e marrëveshjes, pjesa më e madhe bisedojnë në mënyrë konstruktive me furnizuesit për të krijuar një program të reformës.

III. Mbështet fëmijët dhe familjet e tyre

Punëso vëllezërit e motrat më të vjetër apo prindërit

Kur kemi të bëjmë me një situatë kur prindi dhe fëmija punojnë për të njëjtin punëdhënë, mund të konsiderojmë mundësinë e rritjes së pagës për prindin. Në anën tjetër, në qoftë se anëtarët e familjes (prindërit, vëllezërit e motrat më të vjetër) janë të papunë, këta mund të punësohen në vend të fëmijëve.

Mbështet fëmijët në vijimin e shkollës

Menaxherët ose pronarët e kompanive duhet të respektojnë orarin e mësimi të fëmijëve që punojnë dhe nuk duhen penguar ata nga arsimimi i tyre. Arsimimi është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tyre dhe kështu nuk duhet penguar në asnjë mënyrë.

Kërko grupe të tjera të komunitetit, OJQ-të ose të grupeve për mbështetje të ndërsjellë (organizata për kursimeve dhe kredi), që mund të ndihmojnë familjet për të mbajtur nivelin e të ardhurave.

OJQ-të janë duke punuar vazhdimisht për të mbështetur dhe ndihmuar grupe të njerëzve të cilët janë në pozitë më të pafavorizuar dhe kanë nevojë për ndihmë. Ndërmarrjet mund të kërkojnë ndihmë dhe përkrahje prej OJQ-ve për të siguruar një mbështetje financiare për familjet me të ardhura të ulëta.

Skemat e kredive dhe kursimeve

Nga ana tjetër, punëdhënësit mund të ndërmarrin iniciativë për të inkurajuar punëtorët për krijimin e një skeme të kursimeve dhe kredive. Kjo skemë gjithashtu mund t'u sigurojë kredi ose garanci për kredi me kamata me të ulëta për punonjësit e tyre për të mbuluar shpenzimet e arsimit, sidomos në fillim të vitit shkollor, kur duhet të bëhet pagesa e shkollimit.

IV. Përdor kodin e mirësjelljes

Një ndërmarrje mund të deklaroj qasjen e saj ndaj punës së fëmijëve në kodin e saj të mirësjelljes. Një kod i mirësjelljes mund të ketë disa qëllime. Së bashku me promovimin e standardeve të punës dhe përmirësimin e produktivitetit, kodet e tilla mund të rrisin reputacionin e kompanisë, të tërheqin investorët dhe ta bëjnë më të lehtë rekrutimin e stafit të kualifikuar dhe të motivuar.

Një kod i tillë, që është iniciativë vullnetare e ndërmarrjes, mund t'i dedikohet vetëm punës së fëmijëve apo të përfshijë punën e punëtorëve si pjesë e një kodi më të gjerë që përfshinë edhe çështjet tjera të ndërlidhura me punën, si ato sociale ashtu edhe mjedisore.

Kodi i mirësjelljes që merret me punën e fëmijëve përmbush dy objektiva: një të brendshme dhe një të jashtme. Sa i përket aspektit të brendshëm, të gjithë të punësuarit, e veçanërisht ata të përfshirë në punësimin e personelit, mund të vetëdijesohen dhe të përkujtojnë politikat lidhur me punën e fëmijëve, procedurat e ekzaminimit në procesin e punësimit dhe hapat që duhet të ndërmerren për të larguar fëmijët nga puna ose punëtorët e rinj nga kushtet e rrezikshme të punës. Kodi zvogëlon konfuzionin dhe bënë që shkeljet të jenë më lehtë të dukshme.

Sa i përket aspektit të jashtëm, kodi i mirësjelljes mundëson që biznesi t'u tregoj të tjerëve se nuk punëson fëmijë. Kjo veçanërisht mund të jetë e rëndësishme gjatë përpjekjeve për të tërhequr konsumatorë të ri, sidomos për blerësit për të cilët plotësimi i standardeve ndërkombëtare të punës, duke përfshirë punën e fëmijëve, është çështje e rëndësishme.

Një shembull i Kodit të Mirësjelljes të kompanisë "Body Shop":

Nuk përdoret puna e fëmijëve.

1. Nuk do të ketë punësime të reja të fëmijëve.
2. Kompanitë do të krijojnë ose marrin pjesë në dhe kontribuojnë në politikat dhe programet të cilat mundësojnë kalimin e çdo fëmije të gjetur duke punuar si punëtor fëmijë për t'i mundësuar asaj ose atij të ndjek dhe vazhdoj arsimin cilësor derisa më të mos jetë fëmijë; 'fëmijë' dhe 'punë e fëmijës' janë të përkufizuara në shtojcat për Qëllimin, Parimet, Programin: Informata për anëtarësinë e iniciativës së tregut etik.
3. Fëmijët dhe personat e rinj nën moshën 18 vjeçare nuk do të punojnë natën ose në kushte të rrezikshme.
4. Këto politika dhe procedura janë në pajtim me dispozitat e standardeve relevante të ILO-së.

b. Si organizatat e punëdhënësve në Kosovë mund të mbështesin veprimet për parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së

I. Ofro informata dhe këshilla

Në mënyrë që organizatat e punëdhënësve të kenë një rol aktiv në parandalimin dhe eliminimin e FKPF, ato para së gjithash duhet të kenë kapacitetet e duhura profesionale brenda organizatës së tyre. Kjo do të thotë se ato duhet të emërojnë një person që do të merret me çështjet e punës

së fëmijëve. Nëse ky person do t'ia kushtojë kohën me orar të plotë çështjes së punës së fëmijëve apo nëse kjo do të jetë njëra ndër përgjegjësitë e shumta të tij/saj, varet nga madhësia e organizatës së punëdhënësve dhe nga natyra e kërkesës për ndihmë nga anëtarët e saj.

Dhënia e informatave

Informatat për ligjet

Organizatat e punëdhënësve mund të luajnë rol të rëndësishëm në informimin e anëtarëve të tyre dhe njoftimin me dispozitat përkatëse të ligjeve në lidhje me fëmijët dhe punën. Organizatat e punëdhënësve që përfshijnë shoqatat sektoriale si anëtarë të tyre, mund të bashkojnë përkufizime të punëve të rrezikshme për sektorë të ndryshëm ose të drejtojnë anëtarët e tyre tek asociacionet e ndryshme.

Informatat lidhur me blerësit ndërkombëtarë

Organizatat e punëdhënësve mund të kenë një rol të madh në informimin e anëtarëve për të ndryshuar qëndrimet e tyre në drejtim të punëve të fëmijëve. Ne të kaluarën blerësit e mëdhenj vendor dhe ndërkombëtar, mund të mos kenë qenë në dijeni, ose mund të kenë qenë të paaftë për të kuptuar ndaj praktikave të punës së fëmijëve në zinxhirët e furnizimit. Kujdesi është rritur në masë të madhe në dekadën e fundit, e sidomos gjatë pesë viteve të fundit. Kërkesat janë më të larta. Organizatat e punëdhënësve mund të kenë rol të rëndësishëm për të biseduar me blerësit, duke i informuar për qëndrimet e tyre të ndryshuara ndaj punës së fëmijëve dhe t'i informojnë anëtarët e tyre për këto ndryshime. Shoqatat nga sektorë të ndryshëm mund të kenë rol veçanërisht të rëndësishëm në këtë drejtim, pasi që puna e fëmijëve ka tendencë për të kapë vëmendjen nga një perspektivë sektoriale. Anëtarët duhet të dinë po ashtu se kërkesat e blerësve ndërkombëtarë janë shpesh më të larta sesa ligji kombëtar.

Informata për certifikimin

Sa i përket informatave për certifikimin, anëtarët e organizatave të punëdhënësve mund të jenë të interesuar për certifikimin e produkteve të tyre si të prodhuara pa përdorë punën e fëmijëve. Kjo do t'u ndihmojë prodhuesve të interesuar të furnizojnë blerësit ndërkombëtar. Organizatat e punëdhënësve mund të luajnë rolin e tyre për t'i njoftuar kompanitë për llojet e certifikimit të cilat janë të mundshme në sektorin e tyre – si në rrafshin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar – si dhe për përfitimet dhe mangësitë e secilës nga këto.

Ofrimi i këshillave

Këshilla themelore nga personat kontaktues në organizatën e punëdhënësve

Së bashku me informatat tjera, organizatat e punëdhënësve po ashtu mund të ofrojnë këshilla në lidhje me ndaljen e punësimit të punëtorëve të ri fëmijë; sugjerimi i strategjisë për verifikimin e moshës para punësimit; largimi i punëtorëve fëmijë nga punët e rrezikshme; inkurajimi i aktiviteteve që mund të rrisin të ardhurat e familjes; përcaktimi nëse çmimet e shkollimit janë pengesë; dhe gjetja e grupeve që mund të mbështesin të ardhurat e familjes.

Këmbimi i përvojave të mira

Ndërmarrjet mund të mësojmë shumë nga shembujt e ofruara nga ndërmarrjet tjera. Kjo i lejon ata që të mësojnë se çfarë me të vërtetë ka sukses dhe se si të tjerët iu janë qasur problemeve të ngjashme. Si rezultat, organizatat e punëdhënësve mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të dokumentuar shembuj të praktikës së mirë në mes të anëtarëve të tyre dhe përhapjes së këtyre praktikave në mesin e anëtarësisë.

Ndihmë në zgjedhjen e partnerëve

Drejtimi i ndërmarrjeve anëtare të tek partnerët e respektuar dhe të besueshëm për bashkëpunim në aktivitete të përbashkëta për të zvogëluar punën e fëmijëve mund të jetë edhe një nga

aspektet ku organizatat e punëdhënësve mund të ofrojnë këshilla. Në të shumtën e rasteve, këto do të jenë OJQ që mund t'u ofrojnë këshilla ndërmarrjeve dhe mbështesin largimin e fëmijëve nga puna. Ndërmarrjet mund po ashtu të kërkojnë këshilla për gjetjen e partnerëve për monitorim dhe akreditim. Partnerët tjerë mund të përfshijnë bordet e shkollave dhe shoqatat që mund të ndihmojnë për të mbajtur fëmijët në shkollë, mediat e ndryshme që mund të ndihmojnë në ngritjen e vetëdijes, agjencitë ndërkombëtare dhe donatorët, sidomos ato që mund të jenë duke realizuar projekte në afërsi të lokacionit të ndërmarrjes.

Ndihma në hartimin e kodeve të mirësjelljes

Lidhur me kodet e mirësjelljes, ndërmarrjet në Kosovë kanë nivel të ulët të vetëdijesimit për përparësitë e hartimit si dhe ne integrimin kodeve të mirësjelljes në menaxhimin e proceseve të biznesit të tyre. Prandaj, organizatat e punëdhënësve mund të luajnë rol të rëndësishëm në këshillimin dhe mbështetjen e anëtarëve të tyre për hartimin e një kodi të mirësjelljes dhe integrimin e çështjeve që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve në të.

II. Lobo, lehtëso dhe vetëdijeso

Bashkëpunimi me qeverinë

Qeveria është palë shumë e rëndësishme për eliminimin e punës së fëmijëve për shkak të përfshirjes së saj në hartimin e ligjeve për punën e fëmijëve, në zbatimin e këtyre ligjeve dhe në sigurimin e arsimimit të përballueshëm për të gjithë përnda aspekti i kostos (ose falas). Krijimi i bashkëpunimit me qeverinë do tu mundësojë organizatave të punëdhënësve që në mënyrë efektive të llobojë në këto tri fusha të politikave publike. Si hap i parë, organizata e punëdhënësve duhet të jetë pjesë e negociatave për ratifikimin e Konventave të ILO-së dhe OKB-së për moshën minimale të punës, format më të këqija të punës së fëmijëve dhe të drejtat e fëmijëve. Organizata e punëdhënësve duhet të bashkëpunojë me qeverinë dhe punëtorët për të paraqitur këndvështrimin e ndërmarrjes.

Bashkëpunimi me organizatat e punëtorëve

Puna e fëmijëve është çështje e punës kështu që organizatat e punëtorëve marrin pjesë si një nga palët kryesore në këtë proces. Sipas të gjitha gjasave organizata e punëdhënësve do të punojë me organizatat homologe të punëtorëve për aspektet themelore të cilat janë trajtuar në pjesën më lartë për qeverinë, më konkretisht për ratifikimin e konventave, miratimin e ligjeve, arritjen e marrëveshjes për përpilimin e listës së punëve të rrezikshme dhe kryerjen e inspektimit të punës. Në këtë dialog, organizatat e punëdhënësve dhe organizatat e punëtorëve do të jenë në pozita të ngjashme përnda aspekti i përfaqësimit. Kjo do të thotë se këto organizata përfaqësojnë ekonominë formale, përderisa puna e fëmijëve kryesisht ekziston në ekonominë joformale.

Bashkëpunimi me OJQ-të

Organizatat joqeveritare janë një grup i rëndësishëm i aktorëve që bëjnë fushata dhe mbështesin eliminimin e punës së fëmijëve. Edhe ato përbëjnë grupe të ndryshme, disa janë organizata globale, ndërsa të tjera kryesisht veprojnë brenda një vendi të vetëm. Disa kanë ndërmarrje shumëkombëshe të njohura për famën e tyre të keqe, kurse shumë tjera kanë luajtur një rol konstruktiv duke punuar me ndërmarrje për të gjetur zgjidhje për çështje si për shembull përmirësimin e kushteve të punës në fabrikat e tyre dhe të furnizuesve të tyre. Së bashku me angazhimin në fushatë dhe ngritjen e vetëdijes, OJQ-të, posaçërisht në nivelin lokal, kanë ndihmuar në kalimin e fëmijëve prej punës në shkollë.

Ngritja e vetëdijes

Organizatat e punëdhënësve dhe partnerët e tyre realizojnë 'dialog' me qytetarë, ku përfshi-

hen edhe prindërit, por kjo njëkohësisht do të sensibilizon edhe akterët e lartpërmendur. Fushatat publike gjithashtu ndihmojnë të arrihet edhe deri tek ndërmarrjet që nuk janë anëtare të organizatave të punëdhënësve dhe të cilat ka mundësi të funksionojnë në ekonominë joformale, ku edhe gjendet shumica e problemeve me punën e fëmijëve. Qëllimi është që qytetarët të kuptojnë problemin dhe arsyet përse ai gjeneron pasoja negative afatgjata për fëmijët, familjet e tyre dhe për shoqërinë. Kjo ndihmon në fuqizimin e konsensusit social kundër punës së fëmijëve.

III. Realizo programe

Merr iniciativë

Një organizatë e punëdhënësve që merr iniciativë ka vendosur se puna e fëmijëve është problem nga aspekti ligjor, moral ose i biznesit (ose të tria bashkë). Bordi ose stafi i organizatës së punëdhënësve mund të shtroj çështjen, edhe pse shtytja gjithashtu mund të vijë nga anëtarët e saj. Sa i përket kësaj, iniciativa niset nga vetë komuniteti afarist dhe organizata e punëdhënësve pajtohet se një program i tillë është i nevojshëm. Organizata e punëdhënësve mund të nxisë anëtarët e saj, gjatë plotësimit të formularëve për anëtarësim, të jenë të detyruar t'i përmbahen katër parimeve themelore të punës të përcaktuara nga ILO-ja të cilat përfshijnë: lirinë e asociimit, të drejtën për negociata kolektive, eliminimin e punës së detyruar dhe formave më të këqija të punës tek fëmijët dhe diskriminimit.

Anëtarësimi në një iniciativë

Shumë programe të planifikuara për të zvogëluar punën e fëmijëve janë iniciuar nga ILO-ja. ILO-ja është e organizuar në baza trepalëshe, që do të thotë se aktivitetet fokusohen në bashkëpunimin në mes të organizatave të punëdhënësve, punëtorëve dhe qeverisë. Kështu, projektet e ILO-së do të synojnë përfshirjen e organizatave të punëdhënësve dhe punëtorëve edhe pse në shumë raste palë kryesore do të jetë qeveria. Në këto raste, organizatat e punëdhënësve i bashkohen një iniciative të nisur nga të tjerët.

Mbështetja e iniciativës së asociacionit të anëtarëve

Asociacioni i biznesit që është anëtar i një organizate të punëdhënësve mund të ndërmarr vetë një iniciativë për planifikimin e programit. Kjo mund të manifestohet kur i tërë sektori është i kërcënuar nga blerësit dhe konsumatorët për shkak të punësimit të fëmijëve. Anëtarët e tij janë të brengosur për shkak të humbjes së kërkesës dhe ndoshta edhe biznesit dhe i drejtohen asociacionit të tyre për ndihmë.

Zhvillimi i një programi me kalimin e kohës

Me kalimin e kohës, një organizatë e punëdhënësve në të vërtetë mund të dëshirojë ta zhvillojë ekspertizën, njohuritë dhe lidhjet e saj. Ajo mund të fillojë me aktivitetet e informimit dhe dialogut, e pastaj në bashkëpunim me shoqatat e anëtarëve të realizojë aktivitete më konkrete në sektorët kryesor.

Një qasje graduale sjell dy përfitime të rëndësishme. Së pari, një iniciativë e madhe, e përbërë nga komponente të ndryshme dhe me përfshirjen e disa partnerëve mund të jetë e vështirë për t'u menaxhuar për një organizatë të punëdhënësve e cila nuk ka përvojë me punën e fëmijëve. Ndërsa ka pak përvojë në menaxhimin e projekteve që përfshijnë më shumë se vetëm anëtarët e tyre. Së dyti, një nismë e madhe mund të jetë edhe një sukses i madh, por njëkohësisht rrezikon edhe të jetë një dështim i madh.

VI. Çfarë më tej?

a. Analizo situatën në biznesin tuaj

1. Verifiko kërkesat e përcaktuara në Ligjin e punës
 - Mosha minimale e punësimit
 - Orët maksimale në javë gjatë së cilave mund të punësohen në mënyrë të ligjshme fëmijët mbi moshën minimale të punësimit
 - Mosha minimale për përfshirjen e fëmijëve në punë të rrezikshme
 - Përkufizimi ligjor i punës së lehtë, punës së rrezikshme dhe formave më të këqija të punës së fëmijëve
2. Verifiko kërkesat e blerësit tuaj dhe standardet e industrisë
 - Mosha minimale për punë të rregullt, nëse dallon nga ligji
 - Mosha minimale për punë të rrezikshme
 - Format kryesore të punëve të rrezikshme në rrethin e punës tuaj të biznesit të definuar nga industria e juaj ose furnizuesit
 - Kërkesat ISO të blerësve në lidhje me punën e fëmijëve
 - Kërkesat tjera të blerësve ose standardeve të industrisë lidhur me punën e fëmijëve
3. Verifiko punën e fëmijëve në biznesin tuaj
 - Numri i përgjithshëm i fëmijëve (nën moshën 18 vjeçare) që punojnë në biznesin tuaj
 - Numri i fëmijëve që punojnë në biznesin tuaj dhe janë nën moshën minimale të punësimit
 - Numri i fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare që punojnë në punë të rrezikshme
 - Numri i punëtorëve moshë e të cilëve është vështirë të verifikohet
 - Numri i punëtorëve që mund të definoreshin si fëmijë punëtorë nga furnizuesit tuaj

b. Planifiko strategjinë tuaj

Strategjia do të bazohet në objektivat e biznesit dhe në nivelin e problemit të punës së fëmijëve në biznesin përkatës. Bizneset e vogla thjeshtë mund të dëshirojnë që të jenë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Një biznes i madhësisë së mesme mund të dëshirojë të furnizojë firmat tjera ose të futet vetvetiu në tregun e eksportit. Një biznes i madh mund të kërkojë që të sigurojë blerësit dhe konsumatorët ekzistues se nuk shfrytëzon punën e fëmijëve.

Planifikimi i strategjisë për punën e fëmijëve mund të ndjek procesin e përbërë nga tetë hapat i cili është paraqitur në faqen e radhës.

Elementët e strategjisë së punës së fëmijëve

1. Analizimi i situatës
2. Planifikimi i strategjisë (me planin për zbatimin e saj)
3. Tri veprimet e menjëhershme: punësimi, rreziqet dhe oraret
4. Mbështetja e mirëqenies së fëmijës dhe ekonomisë familjare
5. Eliminimi i nevojës për fëmijë në biznesin tuaj
6. Eliminimi i punës së fëmijëve nga zinxhiri furnizues
7. Shfrytëzimi i kodit të mirësjelljes
8. Auditimi, monitorimi dhe certifikimi

Çfarë të bëhet/Çfarë të mos bëhet

- Konsultohu me të tjerët para se të vendosni për strategjinë
- Shfrytëzoni praktikat më të mira të ndërmarrjeve tjera
- Vlerëso në mënyrë reale kohën dhe koston e strategjisë
- Cakto personin kontaktues në organizatën tuaj, për çështjet që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve
- Merr parasysh rolin tuaj karshi punëtorëve dhe qeverisë
- Mos e përmbyll strategjinë shumë herët; lejoje të zhvillohet; ndryshoje sipas nevojës
- Mos e moho publikisht se problemi ekziston
- Mos e injoro rëndësinë e blerësve ndërkombëtarë
- Mos u ligjëro anëtarëve tuaj – më mirë bindi dhe ndihmoju
- Mos puno vetëm – gjej partnerë, duke përfshirë edhe OJQ-të

VII. Shembull i një përvoje të mirë

Moldavia ndodhet në Evropën Juglindore dhe karakterizohet me të ardhura të ulëta, nivel të ulët i BPV-së dhe faktit se rreth gjysma e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë. Përveç kësaj, ekziston mungesë e mundësive dhe zbatim i pamjaftueshëm i politikave sociale që ndikon negativisht në të drejtat themelore të fëmijëve.

Ky shembull u zgjodh për shkak të gjendjes ekonomike dhe çështjeve të punës së fëmijëve me të cilat ballafaqohet Moldavia dhe ngjasie me Kosovën, njëkohësisht mund të përdoret si tregues se si një nismë të këtij lloji mund të realizohet në Kosovë.

Federata Kombëtare e Punëdhënësve në Sektorin e Bujqësisë dhe Industrisë së Ushqimit (FNPAIA) në Moldavi ka realizuar një projekt për të luftuar punën e fëmijëve në bujqësi në Moldavi.

Analiza e situatës

Situata ekzistuese u karakterizua nga fakti se ndërmarrësit në Moldavi nuk kuptonin në mënyrë të duhur punën e fëmijëve dhe e mohonin këtë çështje si një problem. Ka pasur një kërkesë të madhe për fuqi punëtore në bujqësi, ndërsa në të njëjtën kohë një numër i madh i banorëve të Moldavisë shkonin për punë jashtë vendit. Si rezultat i kësaj, shumë fëmijëve ishin të përfshirë në punë të rrezikshme në bujqësi. Në vitin 2005 FNPAIA-ja doli me një vlerësim të shpejtë për punën e fëmijëve. FNPAIA-ja paraqiti rezultatet e gjetura për anëtarët e Këshillit të FNPAIA-së, i cili përbëhet prej ndërmarrjeve nga të gjitha shoqatat e FNPAIA-së në të gjithë vendin. Pas vlerësimit dhe prezantimit të gjetjeve, Këshilli lëshoi një deklaratë më datën 6 tetor 2005: "Vendi i fëmijës është në shkollë dhe puna e fëmijës është të mësojë".

Strategjia

- FNPAIA përfshiu çështjen e punës së fëmijëve në aktivitetet e saj të vazhdueshme dhe trajnoi stafin ekzistues për çështjet e punës së fëmijëve.
- Përpiloi materialet e trajnimit për punën e fëmijëve;
- Themeloi një rrjet të agjentëve të ndryshimit/trajnerëve në të gjithë vendin duke avokuar për luftimin e punës së fëmijëve
- Krijoi një lëvizje "për ndryshimin e qëndrimeve dhe luftimin e punës së fëmijëve
- Përfshiu çështjen e punës së fëmijëve në aktivitetet e saj të vazhdueshme dhe trajnoi stafin ekzistues mbi çështjet e punës së fëmijëve.

Rezultatet dhe arritjet

- Të kuptuarit e çështjes së punës së fëmijëve dhe njohuritë e punëdhënësve për legjislacionin të punës janë përmirësuar
- Angazhimet e punëdhënësve për të eliminuar punën e fëmijëve janë zgjeruar
- Propozimet nga punëdhënësit anëtarë janë grumbulluar dhe janë përfshirë në draftin e Kodit të mirësjelljes
- Kodi i mirësjelljes është miratuar më datën 19 dhjetor 2007 nga Këshilli i FNPAIA-së
- Skema e monitorimit të Kodit të mirësjelljes për punën e fëmijëve është funksionale


ILO
International Programme on
the Elimination of Child Labour (IPEC)

Kosovo IPEC Office
10000 Pristina, Str.Peyton Place, 16, Kosovo

Tel: +381 38 549 066, ext. 285, 255

www.ilo.org/budapest
www.ilo.org/ipec

ISBN 978-92-2-824079-5



9 789228 240795